



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:074634
Datë: 21.12.2021
Numri i dokumentit: 02536547

C.nr.437/20

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Malsor Kryeziu, me praktikanten e kësaj gjykate Yllka Doli, në çështjen kontestimore të paditësit Xh. Sh., nga Gjakova, rr.”. . .”, nr. . . ., të cilin me autorizim e përfaqëson Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Kompania Regjionale e Mbeturinave “. . .”, Sh.A. me seli në Gjakovë, rr.”M. . . .”, p.nr., të cilën me autorizim e përfaqëson B. A., nga Gjakova, për kompensimin e pagave përcjellëse me rastin e pensionimit si dhe e drejta e shpërblimit jubilar, vlera e kontestit 721.46 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik të mbajtur me 30.11.2021, në prezencën e të autorizuarit të paditëses dhe në prezencë të autorizuarit të të paditurës, me dt.21.12.2021 mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Xh. Sh., nga Gjakova, dhe **DETYROHET** e paditura Kompania Regjionale e Mbeturinave “. . .”, Sh.A. me seli në Gjakovë, që paditësit ti paguaj borxhin në emër të një page jubilarë për 19 vitet e përvojës së punës shumë prej 360.73 euro dhe në emër të një page mujore me rastin e pensionimit shumë prej 360.73 euro, përkatësisht shumë e përgjithshme prej **721.46 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në vit, e cila do të llogaritet nga data e marrjes së këtij aktgjykimi (30.11.2021), e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej **259,20 euro** (dyqind e pesëdhjetë e nëntë euro e njëzet cent), në afatin prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

I autorizuari i paditësit në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së precizuar të saj, provave të bashkangjitura në padi ashtu që propozoj që e njëjtat të administrohen dhe nga administrimi i tyre kërkesëpadia do të rezultoi si e bazuar. Sa i përket përgjigjes në padi përkatësisht që e paditura nuk është nënshkruese e marrëveshjes kolektive në bazë të nenit 4 të MPKK-së, është paraparë që dispozitat e asaj marrëveshje obligojnë punëdhënësit në çfarëdo mënyrë të kryejnë veprimtari ekonomike, joekonomike dhe shërbime civile, njëherit duke pasur parasysh nenin 81 të po asaj marrëveshje pas skadimit të afatit të marrëveshjes, afati i sajë është shtyrë edhe për një vit pasi që asnjëra nga palët nënshkruese nuk

është tërhequr nga marrëveshja ashtu që me pensionimin e paditësit e paditura ka qenë e obliguar që paditësit ti kompensoi një pagë përcjellëse dhe një pagë jubilarë për 10 vite të përvojës së punës, pasi që 2 paga përcjellëse ja ka paguar me rastin pensionimit. Ndërsa në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se në këtë çështje duke pasur parasysh obligimet të paditëses për pagimin e shpërblimit jubilar dhe të pagave përcjellëse është vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme se e paditura në rastin e pensionimit këtu paditësit është dashur të ia paguaj shpërblimin jubilar për 10 vite përvoja të punës dhe një pagë përcjellëse, andaj propozojmë gjykatës që kërkesëpadinë në tërësi të aprovoj si të bazuar. Kërkojmë shpenzimet procedurale dhe atë 20 euro për pagimin e taksës gjyqësore, 104.00 euro për përpilimin e padisë dhe 135.20 euro për pjesëmarrjen në seancën e sodit në total 259.20 euro.

I autorizuari i të paditurës në shqyrtim kryesor ka deklaruar se e kundërshtojmë kërkesëpadinë e paditësit në tërësi dhe kërkojmë nga gjykata themelore në Gjakovë që në bazë të vërtetimit dhe administrimit të provave të nxjerrë aktgjykimin në të cilin e refuzon në tërësi si të pa bazuar padinë e paditësit. Bazuar në nenin 90 pika 4 e ligjit të punës ku thotë se marrëveshja kolektive mund të lidhet për një përudhë të caktuar në një periudhë jo më shumë se 3 vjet ndërsa marrëveshja MPKK ka hyrë në fuqi me 01.01.2015 dhe ka përfunduar me 31.12.2017, andaj e njëjta nuk është më në fuqi dhe nuk prodhon më efekt juridik dhe e njëjta nuk ka fuqi prapavepruese, neni 90 paragrafi 5 i ligjit të punës e precizon se marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara në marrëveshjen kolektive. Referohem palës paditëse e cila thirret në nenin 4 të MPKK-së ku në paragrafi 2 të kësaj marrëveshje thuhet se degët e sindikatave të veprimtarive joekonomike (shërbimet civile, publike dhe ndërmarrjeve publike) lidhin kontratë të posaçme me punëdhënësit e tyre. Neni 81 prap i referohem palës paditëse se edhe pas skadimit të marrëveshjes së përgjithshme e njëjta vazhdon edhe për një vit nëse asnjëra nga palët nuk tërhiqet nga marrëveshja, lidhur me këtë oda ekonomike e Kosovës në shkresën numër 392 të datës 15.09.2017 të drejtuar MPMS është tërhequr nga marrëveshja kolektive. Bazuar në të cekurat më lartë mbesim në tërësi si në përgjigjen në padi, duke kërkuar nga gjykata që të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit. Ndërsa në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se mbesim pranë përgjigjes në padi në mënyrë kategorike thirrmi në nenin 4 të MPKK paragrafi 2 me të cilën e paditura deklaroi se nuk ka lidhur asnjë kontratë të posaçme ashtu siç kërkohet me këtë nen, andaj kërkojmë që kërkesëpadia të refuzohet në tërësi.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike në shqyrtimin kryesor ka bërë administrimin e provave dhe atë përgjigja në kërkesë për kompensimin e pagave me rastin e pensionimit dhe shpërblimit jubilarë numër 370 dt.04.03.2020, e lëshuar nga e paditura KRM “. . .”, vendimin e lëshuar nga e paditura KRM “. . .” numër 353 dt.27.04.2018, transaksionet e llogarisë bankare të lësuara nga ProCredit Bankë me dt.25.09.2019, për paditësin Xh. Sh. për periudhën 01.01.2018 deri me 25.09.2018, vendimin e lëshuar nga MPMS, departamenti i pensioneve me dt.04.05.2018, ku pas vlerësimit veç e veç të provave dhe lidhshmërinë e tyre reciproke, e në kuptim të nenit 8 të LPK-së, vërtetojë se kërkesëpadia e paditësit, është në tërësi e pa themeltë dhe si e tillë u refuzua.

Nga provat e administruara, u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

Nga provat e administruara në mënyrë të gjithmbarshme, gjykata ka vërtetuar faktin se nuk është kontestuese se paditësi Xh. Sh., ka qenë i punësuar tek e paditura K.R.M. “. . .”, në Gjakovë, në detyrat e punës Zyrtar i Logjistikës (Furnizues). Paditësit i është ndërpre marrëdhënia e punës me dt.28.04.2018 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Paditësit nga e paditura i janë kompensuar 2 rroga mujore në shumën totale prej 624.80 euro, për shkak të shkuarjes në pension.

Paditësi ka kërkuar nga e paditura kompensimin e pagave me rastin e pensionimit dhe shpërblimin jubilar, mirëpo e paditura e ka njoftuar paditësin se i është refuzuar kërkesa. Paditësi në kohën e pensionimit e ka pasur rrogën 360.73 euro dhe 19 vite përvojë pune të cilat nuk i ka kontestuar e paditura.

Me Ligjin e Punës LIGJI Nr. 03/L-212, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti V / Nr. 90 / 01 DHJETOR 2010, neni 90 është paraparë që *“1. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: 2.1. nivel të vendit, 2.2. nivel të degës, 2.3. nivel të ndërmarrjes. 3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Me nenin 87 të Ligjit është përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*.

Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, është lidhur dhe nënshkruar nga BSPK-ja, Qeveria e R. Kosovës, OEK, KES dhe AKB dhe ka hyrë në fuqi me dt.01.01.2015 dhe ka zgjatur deri me dt.01.01.2019 dhe kjo bazuar në nenin 81 të Marrëveshjes.

Gjykata me rastin e përcaktimit të lartësisë për një pagë përcjellëse në pension në shumën prej 360.73 Euro, është bazuar në historiat e llogarisë bankare e lëshuar nga ProCredit Bankë, për paditësin Xh. Sh., me dt.25.09.2019, të cilën në gjykatë e ka dorëzuar paditësi, nga ku vërtetohet se paditësi para daljes në pension, ka pranuar pagë mujore në shumë prej ka pasur rrogën 360.73 €. Po ashtu e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit lidhur me shpërblimin jubilar në emër të një page mujore tek punëdhënësi i fundit për 19 vite përvojë pune pasi që u vërtetua se paditësi ka më tepër se 19 vite përvojë pune.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 2 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditësi e ka shfrytëzuar një të drejtë pasi që e njëjta përfiton nga kjo kontratë për faktin se me rastin e daljes së tij në pension kontrata kolektive ka qenë në fuqi.

Në nenin 52 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës Nr.38 dt.18.06.2014, e cila kontratë ka hyrë në fuqi me dt.01.01.2015, është përcaktuar që punëtori ka të drejtë në shpërblim jubilar për 10 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të një page bazë, për 20 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë prej dy pagave bazë dhe për 30 vite të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë prej tri pagave bazë, punëdhënësi i fundit është ai që e paguan shpërblimin jubilar, se shpërblimi jubilar paguhet në afat prej 1 muaji pas plotësimit të kushteve nga kjo pikë, çka do të thotë se e paditura është dashur që me rastin e daljes në pension paditëses brenda 1 muaji sipas nenit 52 par.2 dhe 3, t'ia paguajë tri paga jubilarë pasi që i ka plotësuar këto kushte, pasi që paditësja ka përvojën e punës mbi 30 vjeçare dhe ka qenë obligim i të paditurës që të bëjë pagesën pa pasur nevojë as për të paraqitur ndonjë kërkesë qoftë gojore apo me shkrim të paditurës.

Kurse neni 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, është përcaktuar se punëtori ka të drejtë që me rastin e pensionimit në pagesat përcjellëse në lartësi të tri pagave

sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit, e në rastin konkret, gjykata ka marr parasysh që e paditura i ka paguar dy pagat e fundit për shkak të pensionimit ndërsa nuk i ka paguar edhe një pagë në lartësi prej 360.73 €.

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”. prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditorit, përkatësisht këtu paditësit në rastin konkret, të ia paguajë vlerën e kërkesëpadisë si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç më detalisht është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoj pretendimet e palës së paditur, mirëpo pretendimet e tilla nuk qëndrojnë për faktin se Gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka dal në pension me dt.28.04.2018, ndërsa Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive të Kosovës Nr.38 është e lidhur dhe e nënshkruar nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, Qeveria e Kosovës, OEK-u, KES dhe AKB, e cila kontratë ka hyrë në fuqi me dt.01.01.2015 dhe ka pasur afat deri 01.01.2019 pasi që asnjëra nga palët nënshkruese nuk është tërhequr ashtu siç është përcaktuar me nenin 81 të marrëveshjes.

Po ashtu edhe pretendimet e tjera të të paditurës, mirëpo të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje kontesimore, pasi që me marrëveshjen kolektive me dispozitat e saj me nenet 1, 2 dhe 3, në mënyrë decitive është paraparë qëllimi i marrëveshjes, fushëveprimi i saj dhe aplikimi dhe përfshirja, andaj pretendimet e tilla kjo Gjykatë nuk e mori parasysh duke i konsideruar të njëjtat pa ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes, nga se nuk kishin mbështetje ligjore.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi bazur në nenin 143 të LPK-së, lidhur me nenin 52, 53 dhe 81 par 1 dhe 2 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerrë konform nenit 452.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.437/20, me 21 dhjetor 2021

G j y q t a r i
Malsor Kryeziu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.